



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“PYJE”

Niveli II në KSHK¹, referuar nivelit II të KEK²

S-II-22

Tiranë, 2022

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	Pyje			Kodi
Kohëzgjatja	1900-2100 orë	Niveli	II në KSHK, referuar nivelit II të KEK	S-II-22
Qëllimi:	<p>Qëllimi i kualifikimit profesional” Pyje” niveli II-të në KSHK, referuar nivelit II të KEK, është të përgatisë punonjës me kualifikim bazë ndihmës (punëtor gjysmë të kualifikuar) në fushën e shtimit dhe shfrytëzimit të pyjeve dhe kullotave, si dhe të zhvillojë personalitetin e individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.</p>			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional “Pyje” niveli II-të në KSHK, referuar nivelit II të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> – kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar; – janë në kushte shëndetësore që e lejojnë kryerjen e detyrës për përballimin e kërkesave të këtij niveli të arsimit profesional; – kanë aftësi të kufizuara, për të cilët institucioni arsimor krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Pyje”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, e pajis individin me certifikatën profesionale dhe suplementin e certifikatës profesionale të nivelit, të punonjësit ndihmës (gjysmë të kualifikuar), të cilat njihen në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Ky arsimim profesional i jep individit mundësi t’i drejtohet tregut të punës si punonjës ndihmës (gjysmë i kualifikuar) në shtimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e pyjeve dhe kullotave, në mbledhjen e produkteve jodrusore, në prerjen dhe stivosjen e drurëve etj..</p> <p>Për sa i përket arsimimit të mëtejshëm, individi ka mundësi të vazhdojë studimet në një nga kualifikimet e nivelit IV të KSHK-së, referuar nivelit IV të KEK, ku individi fiton të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
Data e validimi				
Data e miratimit				
Variantet mëparshme	S-I-12; S-II-16			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI PROFESIONALE

Individi duhet të dijë:

Vizatimi teknik:

- Të listojë mjetet e vizatimit teknik;
- Të përshkruajë përdorimet e mjeteve të vizatimit;
- Të tregojë mënyrat e vendosjes së përmasave në objekte të ndryshme;
- Të përshkruajë shkallët e vizatimit në planimetri të sipërfaqeve dhe objekteve të thjeshta;
- Të interpretojë skicat me përmasat e tyre;
- Të përshkruajë projeksionet ortogonale dhe aksonometrike të trupave të rregullt gjeometrikë;
- Të përshkruaj një nga programet bazë të vizatimit me kompjuter.

Botanikë pyjore

- Të përshkruajë qelizën bimore, indet dhe pjesët kryesore të bimëve me klorofil;
- Të shpjegojë funksionet e rrënjës, kërcellit, gjetes, lules, frutit dhe farës; format kryesore dhe ndërtimin e tyre;
- Të përshkruajë proceset jetësore të bimës: fotosintezën, transpirimin, frymë marrjen, dhe rritjen drurëve pyjor (primare dhe sekondare);
- Të përshkruajë fenologjinë e bimëve dhe rëndësinë praktike të njohjes së fazave fenologjike tek drurët pyjor;
- Të përshkruajë mënyrat e riprodhimit të bimëve;
- Të listojë parimet kryesore të klasifikimit të bimëve, sistematika e bimëve të ulëta dhe të larta;
- Të përshkruajë karakteristikat morfologjike të drurëve dhe shkurreve;
- Të shpjegojë kërkesat ekologjike të llojeve pyjorë ndaj tokës dhe klimës, përshtatjen dhe zhvillimin e tyre;
- Të përshkruajë llojet e drurëve me rritje të shpejtë dhe që kanë vlera për industrinë përpunuese të lëndës së drurit, prodhim bioenergjie dhe sekuestrim karboni.

Njohuri në silvikulturë dhe mbrojtje të pyjeve

- Të përshkruajë elementet përbërës të pyllit si bashkësi jetese;
- Të përshkruajë katet e bimësisë së pyllit dhe karakteristikat e tyre;
- Të përshkruajë funksionet e pyllit, sistemet ekologjike dhe ndikimin e tyre në prodhimtarinë e drurëve e të bimësisë pyjore;
- Të përshkruajë fazat e zhvillimit të grumbujve pyjor dhe ndërhyrjet kryesore në çdo fazë zhvillimi;
- Të përshkruajë teknikat e punimeve në mirëmbajtjen e pyjeve (punime kulturore dhe ripërtëritje të pyjeve);
- Të përshkruajë elementët dendrometrikë të drurit, instrumentet kryesore që përdoren në matjen e drurëve në grumbullin pyjor;
- Të përshkruajë mënyrën e procesit të damkimit;

- Të përshkruajë sëmundjet dhe dëmtuesit kryesorë të drurëve pyjorë; në pyje dhe fidanishte pyjore;
- Të përshkruajë metodat kryesore të luftimit të dëmtueseve dhe të sëmundjeve në pyje dhe fidanishte pyjore;
- Të përshkruajë faktorët e shfaqjes së zjarreve në pyje dhe kullota, masat kryesore në vërtetim sinjalizim dhe shuarjen e tyre;
- Të listojë masat karantinuese në fidanishte dhe rezervatet farore;
- Të përshkruajë praktikatat për sigurinë dhe shëndetin në punimet silvikulturore;

Punime pyllëzimi dhe fidanishte

- Të përshkruajë profilin e tokës, horizontin, cilësitë fiziko-mekanike dhe përmbajtjen e lëndëve ushqyese të tokës;
- Të përshkruajë llojet më të përdorshme të plehrave, mënyrat dhe sasi të duhura që përdoren në fidanishte dhe pyllëzime;
- Të përshkruajë mënyrat e grumbullimit, ruajtjes dhe trajtimit të frutave dhe farave pyjore;
- Të përshkruajë masat profilaktike të tilla si: dezinfektimi dhe trajtimet kimike që u bëhen fidanëve pyjor para mbjelljes në objektet e pyllëzimeve, etj.;
- Të përshkruajë mënyrat e punimit të tokës në fidanishte dhe në objekte pyllëzimi;
- Të përshkruajë mënyrat e mbjelljes së farërave dhe të fidanëve pyjore;
- Të përshkruajë operacionet e punës gjatë dhe pas procesit të mbjelljes të farërave dhe fidanëve pyjorë;
- Të përshkruajë mënyrat e shtimit vegetativ të bimësisë pyjore dhe afatet e mbjelljes;
- Të përshkruajë mënyrat e shtimit me farë të bimësisë pyjore dhe afatet e mbjelljes;
- Të listojë mënyrat e shtratifikimit të farërave dhe fidanëve pyjore;
- Të listojë llojet e ambalazhimeve të fidanëve pyjore;
- Të përshkruajë fenomenin e gërryerjes së tokës, faktorët që favorizojnë dhe e ndalojnë atë.

Mbarështimi i faunës pyjore

- Të përshkruajë veçoritë biologjike të kafshëve dhe shpendëve të egër;
- Të përshkruajë rëndësinë e shtimit artificial të faunës;
- Të listojë speciet në rrezik zhdukje të faunës;
- Të përshkruajë rregullat dhe mënyrat kryesore të ushtrimit të gjuetisë, kalendarin e gjuetisë dhe normat e lejuara të gjahut të vrarë, sipas specieve;
- Të përshkruajë punimet e inventarizimit të faunës në pyll;
- Të përshkruajë llojet e strehimit të faunës në rezervate dhe mjedise të hapura pyjore për jetesë dhe ripopullim;
- Të përshkruajë llojet e kurtheve, leqeve, qarqeve, kafazeve dhe pengesave të tjera artificiale dhe natyrore në pyje.

Njohuri bazë mbi shfrytëzimin e pyjeve

- Të përshkruajë punimet përgatitore për shfrytëzimin e ngastrave pyjore;
- Të përshkruajë mjetet dhe teknikat për rrëzimin e drurëve, asortimin dhe standardet e lëndës drusore;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjes së vëllimit të drurit të rrezuar dhe asortimenteve kryesore të lëndës drusore në pyll;
- Të përshkruajë përdorimin e veglave dhe mjeteve të thjeshta të dorës në punimet e shfrytëzimit të pyjeve;
- Të shpjegojë ndërtimin dhe funksionin e motosharrave;

- Të përshkruajë transportin e brendshëm të materialit drusor me mjetet dhe mekanizmat përkatës si dhe ngarkimin me krahë të materialeve drusore.

Produkte jo drusore

- Të përshkruajë llojet e produkteve pyjore jo drusore në pyje dhe kullota;
- Të përshkruajë teknikat e mbledhjes dhe mënyrën e transportimit nga vend mbledhja në pikën e përpunimit;
- Të përshkruajë mjetet kryesore dhe teknikat e tharjes së produkteve pyjore jo drusore;
- Të shpjegojë teknikat e përpunimit të produkteve pyjore jo drusore kryesore;
- Të përshkruajë standardet kryesore në ambalazhimin, paketimin dhe etiketimin e produkteve pyjore jo drusore;
- Të listojë teknikat e krasitjes së shelgjishteve, të mersinës apo bimëve të tjera që grumbullohen si degë të gjelbra.

Punime ndërtimore në pyje

- Të përshkruajë llojet e drurëve që përdoren për ndërtimin e gardheve dhe teknikat e ndërtimit të tyre;
- Të listojë llojet e punimeve hidroteknike në sistemimin e përrenjve malorë;
- Të përshkruajë teknikën e ndërtimit të pritave të thata, të pritave me llaç çimento dhe me kosha gabion;
- Të listojë llojet dhe markat kryesore të llaçeve dhe betoneve;
- Të përshkruajë përmasat dhe teknikat e ndërtimit të rrugëve të kafshëve, të traktorëve dhe të rrugëve autopsyjore me krahë;
- Të përshkruajë llojet e kalldrëmit dhe teknikat e ndërtimit të tyre;
- Të përshkruajë skelat e përhershme dhe provizore prej druri dhe përmasat e ndërtimit të tyre për të kryer punime ndërtimore në pyje.

Njohuri bazë mbi kullotat

- Të përshkruajë livadhet dhe kullotat, kositjen e barit dhe përpunimin e tij;
- Të listojë bimët helmuese dhe shkurret e dëmshme në kullota;
- Të përshkruajë punimet e përmirësimit të kullotave dhe mbrojtjes së tokës nga gërryerjet;
- Të listojë masat mbrojtëse të kafshëve në livadhe dhe kullota;
- Të përshkruajë radhën e punës për ndërtimin e lerave me plastmas dhe atyre me beton;
- Të përshkruajë radhën e punës për ndërtimin e lugjeve për ujëpirje;
- Të përshkruajë masat mbrojtëse të kafshëve në kullote;
- Të përshkruajë punimet sipërfaqësore në përmirësimin e kullotave dhe mbrojtjen e tokës nga gërryerjet;
- Të përshkruajë llojet kryesore të florës së kullotave;
- Të përshkruajë mënyrën e mbjelljes së barit në sipërfaqet e zhveshura të tokës.

Rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtja e mjedisit

- Të përshkruajë Standardin kombëtar për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik;
- Të shpjegojë manualët e pajisjeve të punës;
- Të shpjegojë sinjalistikat në mjedisin e punës;
- Të shpjegojë procedurat e evakuimit për raste të ndryshme emergjence;
- Të përshkruajë përdorimin i kutisë së MZSH3;

³Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi

- Të përshkruajë llojet e mjeteve të ndihmës së parë dhe përdorimin e tyre;
- Të shpjegojë procedurat e dhënies së ndihmës së parë;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- Të përshkruajë rreziqet kryesore të ndotjes së ambientit dhe masat përkatëse për eliminimin e ndotjes;

Komunikimi dhe etika profesionale

- Të përshkruajë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Të përshkruajë parimet e punës në grup;
- Të shpjegojë si përdoren rregullat e komunikimit me eprorë dhe kolegët;
- Të përshkruajë mënyrat e marrjes së udhëzimeve nga bashkëpunëtorë për realizimin e detyrës duke përdorur terminologji të qartë dhe profesionale;
- Të shpjegojë si të informohet mbi teknologjitë bashkëkohore të informacionit dhe komunikimit;
- Të përshkruajë parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikim

SHPREHI PROFESIONALE

Individi duhet të jetë i aftë:

Organizimi i punës

- Të organizojë sipas standardeve përkatëse vendin e punës;
- Të sistemojë pajisjet dhe veglat e punës;
- Të përzgjedhë materialet, pajisjet dhe veglat e punës për çdo operacion pune;
- Të zbatojë rregullat e përgjithshme të mbrojtjes dhe shëndetit në punë;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik për çdo operacion pune;
- Të respektojë normat, kodet ligjore dhe etike të marrëdhënieve të punës me punëdhënësin apo koleget.

Vizatimi teknik

- Të kryejë vizatime të thjeshta me dorë të lirë dhe me mjete të tjera të vizatimit;
- Të vizatojë detale të ndryshme, jo të komplikuar duke vendosur përmasat;
- Të zbatojë shkallët e vizatimit në planimetri të sipërfaqeve dhe objekte të thjeshta;
- Të lexojë skicat me përmasat e tyre;
- Të përdorë mjetet e thjeshta të matjeve si vizore, kompas, kalibër, etj.;
- Të vizatojë projeksione ortogonale dhe aksonometrike të trupave të rregullt gjeometrikë;
- Të realizojë skica të thjeshta me dorë dhe kompjuter për gjelbërim banesash dhe mjedise të vogla urbane.

Botanikë pyjore

- Të analizojë qelizën bimore, indet dhe pjesët kryesore të bimëve;
- Të përcaktojë funksionet e rrënjës, kërcellit, gjethes, lules, frutit dhe farës; format kryesore dhe ndërtimin e tyre;
- Të përcaktojë fazat fenologjike të bimëve dhe rëndësinë praktike të njohjes së tyre tek drurët pyjor kryesorë;

- Të përzgjedhë disa nga bimët e ulëta dhe të larta të botës bimore që formojnë grumbuj pyjor në vendin tonë;
- Të përcaktojë karakteristikat morfologjike të drurëve dhe shkurreve pyjore më të përhapura në pyjet e vendit tonë;
- Të përcaktojë kërkesat ekologjike më kryesore të llojeve pyjorë për t'u zhvilluar në një mjedis të caktuar ekologjik;
- Të përzgjedhë llojet e drurëve me rritje të shpejtë dhe që kanë vlera për mbrojtje të tokës nga gërryerjet, vlera industriale, për prodhim bioenergje dhe sekuestrim karboni.

Punime silvikulturore dhe mbrojtje e pyjeve

- Të vendosë shenjat në sipërfaqe dhe në drurë ku do të zbatohen prerje kulturore, sipas udhëzimeve të dhëna;
- Të kryejë procesin e shënimit të drurëve në ngastrat që do përshkohen me prerje kulturore.
- Të kryejë procesin e damkimit të drurëve në ngastrat që do përshkohen me prerje shfrytëzuese.
- Të zbatojë teknikat e punimeve në mirëmbajtjen e ripërtëritjes së pyjeve. (përfshihen të gjitha prerjet kulturore dhe ricungimet);
- Të përdorë instrumente të thjeshta dendrometrikë për matje të drurit në lartësi dhe diametër;
- Të përdorë mjetet e thjeshta për matjen e distancave dhe të pjerrësisë së terrenit në ngastrat dhe rrugët pyjore;
- Të përdorë "Turjelën Pressler" për nxjerrjen e mostrave për përcaktimin e moshës së drurit;
- Të kryejë hapjen e profilit të tokës për marrjen e mostrave për analiza.
- Të identifikojë disa nga sëmundjet dhe dëmtuesit kryesorë të drurëve pyjorë;
- Të zbatojë metodat e luftimit të dëmtuesve dhe sëmundjeve në pyje dhe fidanishte pyjore sipas udhëzimeve përkatëse;
- Të zbatojë masat parandaluese ndaj zjarreve në pyje dhe kullota sipas programeve të MNZ;
- Të zbatojë masat për luftimin dhe izolimin e zjarreve në pyje sipas teknikave përkatëse;
- Të zbatojë masat karantinuese për mbrojtjen e pyjeve nga dëmtuesit dhe sëmundjet sipas rregulloreve përkatëse.
- Të zbatojë masat për mbrojtjen e burimeve gjenetike pyjore sipas manualeve përkatëse;
- Të zbatojë masat për pakësimin e llojeve invazive (pushtuese) në pyje sipas specifikimeve teknike;
- Të zbatojë rregullat dhe praktikat për sigurinë dhe shëndetin në punimet silvikulturore.

Punime pyllëzimi dhe fidanishte.

- Të grumbullojë fara pyjore të drurëve halorë dhe fletorë sipas periudhës së caktuar;
- Të kryejë ruajtjen dhe trajtimin e farave sipas kushteve teknike;
- Të përgatisë tokën për mbjelljen e farërave pyjore në mjedis të hapur ose në sera; sipas specifikimeve teknike të dhëna;
- Të mbjellë farat në mjedis të hapur ose në sera sipas specifikimeve teknike të dhëna;
- Të kryejë shërbime në fidanishte pyjore sipas specifikimeve teknike të dhëna;
- Të seleksionojë fidanët pyjorë sipas kategorive përkatëse;
- Të ambalazhojë fidanë pyjorë duke respektuar kushtet e sigurisë në transport;
- Të shtratifikojë fidanë pyjorë sipas udhëzimeve teknike;
- Të transportojë fidanët pyjorë në objektin e pyllëzimit me mjetet e përshtatshme;
- Të kryejë punime përgatitore në pyllëzime sipas udhëzimeve të dhëna;
- Të përgatisë tokën për mbjellje e fidanëve sipas përcaktimeve në projekt;

- Të mbjellë fidanë pyjorë sipas kushteve teknike;
- Të kryejë shërbime pas mbjelljes sipas përcaktimeve në projekt;

Mbarështimi i faunës pyjore

- Të kryejë shpërndarjen e ushqimit për faunën në rezervate apo habitatet të hapura pyjore dhe kullosore sipas llojeve dhe stinës;
- Të kryejë punime në rezervate apo mjedisë të hapura pyjore e kullosore, për strehim, ujëpirje dhe ripopullim të faunës dhe shpendëve sipas llojeve dhe stinës;
- Të kryejë punime për vrojtim e inventarizim të faunës dhe zhvillim të gjuetisë sipas udhëzimeve;
- Të kryejë punime për lëvizje të lirë të faunës në mjediset pyjore dhe kullosore, duke hequr pengesat natyrore apo ato artificiale sipas udhëzimeve;
- Të kryejë punime në mjediset pyjore/ kullosore dhe zonat e mbrojtura për parandalimin e dëmtimit dhe shqetësimit të faunës dhe shpendëve sipas llojeve dhe stinës.

Punime të thjeshta mbi shfrytëzimin e pyjeve

- Të kryejë punime përgatitore për shfrytëzimin e ngastrave pyjore sipas udhëzimeve përkatëse;
- Të presë vetëm drurët e damkosur;
- Të përzgjedhë mjetet për rrëzimin dhe asortimin e drurëve;
- Të kryejë transportin e brendshëm të materialeve drusore me mjete dhe mekanizmat që disponon;
- Të kryejë stivosjen dhe depozitimin e materialit drusor në sheshet e depozitimit dhe pikat e ngarkimit,;
- Të pastrojë ngastrat pyjore mbas shfrytëzimit dhe të depozitojë mbetjet në vendet e përcaktuara sipas rregullave teknike.

Produkte jo drusore

- Të zbatojë metodat e duhura në grumbullimin e bimëve mjekësore dhe produktet e tjera jo drusore në pyje dhe kullota;
- Të transportojë produktet jo drusore me mjete krahu si: kosha, thasë, tezga, etj. nga vendmbledhjet në pikën e grumbullimit sipas kushteve teknike;
- Të kryejë pastrimin fillestar dhe të shpërndajë materialin e mbledhur për tharje në hije apo diell, në mjedis të hapur, të përgatitura sipas llojeve dhe kushteve atmosferike;
- Të përzgjedhë bimët mjekësore në: herba, gjethe, lule, fruta, fara, etj., sipas standardeve të kërkuara;
- Të ambalazhojë produktet pyjore jodrusore sipas kërkesave, për tregun vendas apo eksport;
- Të etiketojë produktet pyjore jodrusore sipas kërkesave, për tregun vendas apo eksport;
- Të kryejë nxjerrjen e rrënjëve dhe zhardhokëve të ndryshëm nga toka, pastrimin dhe përpunimin e tyre sipas kushteve teknike;
- Të kryejë prerjen e thuprave të shelgut, e degëzave të gjelbra të llojeve të ndryshme, hunjve dhe fashinave sipas rregullave teknike.

Punime ndërtimore në pyje

- Të ndërtojë gardhe teke dhe çifte sipas kushteve teknike;
- Të ndërtojë prita malore me mur guri të thatë, Ilaç-betoni dhe kosha gabioni sipas skicës së dhënë;
- Të kryejë hapjen e rrugëve për lëvizjen e kafshëve dhe të traktorëve në ngastrat e shfrytëzimit sipas projektit të dhënë;

- Të ndërtojë skela prej druri dhe sheshe depozitimi në tokë sipas kushteve teknike;
- Të ndërtojë superstrukturën e rrugëve autopsyjore (kalldrëm, kanale kullim ujërash, ura të thjeshta me trungje druri, etj.) sipas skicave teknike të dhëna.

Kullotat

- Të realizojë me mjete rrethore rrethime të zonave që kositen;
- Të kryejë punime për mirëmbajtjen e kullotave (pastrim bimësh e shkurre të dëmshme dhe gurësh, mbrojtje nga gërryerjet etj.);
- Të përcaktojë radhën e punës dhe proceset e ndërtimit të lerave prej plastmase dhe të lugjeve të ndryshme për ujëpirje;
- Të ndërtojë ngrehina të thjeshta për mbrojtje të kafshëve në kullota sipas nevojave në raste stuhie dhe nga rrezatimi diellor;
- Të kryejë punime përgatitore për MNZ (mbrojtje nga zjarri), si vendosje tabelash, hapje breza mbrojtës, sigurim uji për shuarje zjarri, etj..

Rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtja e mjedisit

- Të zbatojë manualët përkatëse në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të përdorë mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes individuale dhe kolektive në punë sipas udhëzimeve të dhëna dhe manualeve përkatëse;
- Të respektojë sinjalistikën në mjediset e punës sipas rregullores të brendshme të miratuara;
- Të pajiset me kartelën e instruktimit të sigurimit teknik të nënshkruar nga instruktori përkatës,
- Të pajiset me paketën e plotë individuale të ndihmës së shpejtë për përdorimin në raste nevojë;
- Të kryejë dhënien e ndihmës së parë në rast aksidenti sipas procedurës;
- Të zbatojë rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit sipas rregullores përkatëse;
- Të zbatojë rregulloret përkatëse gjatë përdorimit të solucionëve me përmbajtje kimike sipas llojit;
- Të identifikojë dhe të raportojë sipas rastit të personat përgjegjës për mos funksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të pastrojë dhe sistemojë rregullisht vendin e punës; para, gjatë dhe pas punës sipas llojit të punimeve;
- Të ruajë dhe depozitojë mbetjet nga procesi i punës në përputhje me rregulloret e mjedisit;
- Të zbatojë parimet e mbrojtjes së mjedisit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm;
- Të zbatojë protokollin e duhura në raste pandemie;
- Të zbatojë planin e evakuimit në raste emergjence sipas procedurës respektive.

Komunikimi dhe etika profesionale

- Të përcaktojë nevojat specifike për trajnim;
- Të identifikojë metodat e përshtatshme për zhvillimin profesional;
- Të zbatojë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Të zbatojë parimet e punës në grup;
- Të zbatojë rregullat e komunikimit me eprorë dhe kolegët;
- Të zbatojë udhëzimeve marra nga bashkëpunëtorë për realizimin e detyrës duke përdorur terminologji të qartë dhe profesionale;
- Të zbatojë teknologjitë bashkëkohore të informacionit dhe komunikimit;
- Të respektojë parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikim

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij/saj personal dhe profesional;
- Të përfshihet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të nxisë aftësitë e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integritimeve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij/saj;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënimit të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij/saj.